<p>e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i bankës apo institucioni financiar. Njoftimi mund të bëhet gojarisht, por njoftimi i tillë nuk e anulon detyrimin e dorëzimit të raportit të shkruar në pajtim me nenet 22.1 dhe 22.3.</p> <p>6. Pas njoftimit, në pajtim me nenin 21.5, NJIF-ja mund të udhëzojë bankën apo institucionin financiar që të pezullojë ndërmarrjen e veprimit nga neni 17.6. lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë për një kohë maksimale prej 48 orëve ose 2 ditë pune, varësisht se cila periudhë është më e gjatë. Pezullimi i tillë i veprimit në pajtim me këtë nen nuk i komunikohet asnjë personi apo subjekti, duke përfshirë edhe klientin, pa pëlqimin e NJIF-së.</p>	<p>the transaction from the control of the bank or financial institution. The notification may be made orally, but such notification does not abrogate the duty to file written reports pursuant to articles 22.1 to 22.3.</p> <p>6. Upon notification pursuant to article 21.5, the FIU may instruct the bank or financial institution to suspend the taking of an action referred to in article 17.6. in connection with a suspicious act or transaction for a maximum of 48 hours, or 2 working days, whichever period is longer. Such suspension of an action pursuant to the present article shall not be communicated to any person or entity, including the client, without the consent of the FIU.</p>	<p>transferom imovine koja podleže kontroli i transakciji banke ili finansijske institucije. Informacija može da se prenese usmeno, ali takva informacija ne izuzima obavezu da se predaje pismeni izveštaj u skladu sa članom 22.1 i 22.3.</p> <p>6. Nakon informisanja u skladu sa članom 21.5 OFJ može da uputi banku ili finansijsku instituciju na obustavu postupka iz člana 17.6 vezano za akt ili sumnjivu transakciju najviše 48 sata ili 2 radnih dana za visno koji je period duži. Takva obustava postupka u skladu sa ovim članom ne saopštava se nijednom subjektu ili licu, uključujući i klijenta, bez odobrenja OFJ-a.</p>
<p>Neni 23 Bankat dhe institucionet financiare: Programet e brendshme</p>	<p>Article 23 Banks and Financial Institutions: Internal Programs</p>	<p>Član 23 Banke i finansijske institucije: Unutrašnji programi</p>
<p>1. Bankat dhe institucionet financiare do të caktojnë një person kontaktues i cili do të jetë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim informacionesh me BQK-në dhe NJIF-në, i cili u nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe mbajtjes së shënimeve sipas këtij Ligji. Banka apo institucioni financiar e informon Departamentin Mbikëqyrës të Bankave pranë BQK-së dhe NJIF-in për identitetin e personit kontaktues brenda 30 ditëve nga shpallja e këtij Ligji dhe pas kësaj informimin për çfarëdo</p>	<p>1. Banks and financial institutions shall appoint a contact person to be responsible for interaction and information exchange with the CBK and the FIU, and compliance with the reporting and record keeping obligations under this Law. The Bank or financial institution shall inform the Bank Supervision Department of the CBK and the FIU – of the identity of the contact person within 30 days of the promulgation of this law and, thereafter, within 30 days of any change in the designated contact person.</p>	<p>1. Banke i finansijske institucije određuju kontaktnu osobu koji je odgovaran za veze i razmenu informacija sa CKB i OFJ i podležu obavezama izveštavanja i vođenja beleški prema ovom zakonu. Banka i finansijska institucija informišu nadzorni departman banaka pri CKB i OFJ o identitetu kontaktne osobe u roku 30 dana od dana donošenja ovog zakona, i nakon toga o svakoj izmeni vezano za kontaktnu osobu, u roku od 30</p>

<p>ndryshimi të personit kontaktues të caktuar e bënë brenda 30 ditëve.</p> <p>2. Bankat dhe institucionet financiare do të nxjerrin procedura të brendshme të shkruara dhe do të vendosin kontroll për parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjes së parave dhe do t'i zbatojnë ato. Këto procedura mes tjerash përfshijnë, por nuk kufizohen në:</p> <p>2.1. procedurën për identifikimin e klientit;</p> <p>2.2. procedurën për grumbullimin e të dhënave, ruajtjen e shënimeve në pajtim me këtë Ligj dhe për parandalimin e qasjes së paautorizuar;</p> <p>2.3. procedurën e raportimit tek NJIF-ja, në pajtim me neni 22.1. deri në nenin 22.6;</p> <p>2.4. masat që duhet të ndërmerren nga banka apo institucioni financiar nga çasti i zbulimit të aktit ose transaksionit të dyshimtë deri në dorëzimin e raportit te NJIF-ja në pajtim me nenet 22.1 deri në nenin 22.6;</p> <p>2.5. rregullat për përpunimin ose marrjen e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e dyshuar, duke përfshirë masat për ndalimin e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar pa e njoftuar Qendrën në pajtim me nenin 22.5;</p> <p>2.6. procedurat për sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin e punëtorëve mbi përgjegjësitë e parapara në këtë nen dhe parandalimin e shpëlarjes së parave dhe funksionin e auditorit për të</p>	<p>2. Banks and financial institutions shall promulgate written internal procedures and controls for the prevention and detection of money laundering and shall enforce them. Such procedures shall include, but need not be limited to, the following:</p> <p>2.1. a client identification procedure;</p> <p>2.2.a procedure for collecting information and maintaining records in accordance with this Law, and for preventing unauthorized access;</p> <p>2.3. a procedure for reporting to the FIU in compliance with articles 22.1. to 22.6;</p> <p>2.4. measures to be taken by a bank or financial institution from the moment of the detection of a suspicious act or transaction to the submission of the report to the FIU in accordance with articles 22.1 to 22.6;</p> <p>2.5. rules for processing, or taking further action in connection with, a suspicious act or transaction, including measures to prevent further action in connection with a suspicious act or transaction without notification to the FIU in accordance with article 22.5;</p> <p>2.6. Procedures for ensuring the institution and provision of an employee training program on the responsibilities set forth in the present article and the prevention of money laundering; and an audit function to test the</p>	<p>dana.</p> <p>2. Banke i finansisjke institucije će doneti unutrašnje pravilnike i postavljaju kontrolu za sprečavanje i otkrivanje pranja novca. te procedure između ostalog obohvataju i ne ograničavaju se samo na:</p> <p>2.1. procedure za identifikaciju klijenta</p> <p>2.2. proceduru za prikupljanje podataka i vođenje beleški u skladu sa ovim zakonom i sprečavanje ne ovlašćenog pristupanja</p> <p>2.3. proceduru izveštavanja OFJ-o u skladu sa članom 22.1 do 22.6;</p> <p>2.4. mere, preduzete od banke i finansisjke institucije u trenutku otkrivanja sumnjive transakcije i akta do podnošenja izveštaja OFJ-u u skladu sa članom 22.1 do 22.6;</p> <p>2.5. pravila o izradi ili preduzimanju daljih procedura vezano za sumnjivi akt ili transakciju uključujući i mere za sprečavanje daljih postupaka vezano za sumnjivu transakciju bez u poznavanja Centra u skladu sa članom 22.5;</p> <p>2.6. proceduru obezbeđivanja i finansiranja programa preobučavanja radnika vezano za odgovornostima iz ovog člana za sprečavanje pranja novca i</p>
---	--	---

<p>testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit.</p> <p>3. Bankat dhe institucionet financiare do t'i dorëzojnë NJIF-së procedurat e parapara në nenin 23.2 jo më vonë se 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij neni ose 30 ditë pas themelimit të bankës ose institucionit financiar. Nëse procedurat shkelin atë, NJIF-ja e njofton bankën ose institucionin financiar për shkeljet. Banka ose institucioni financiar procedurat e ndryshuara i dorëzon brenda 30 ditëve.</p>	<p>reporting and identification system.</p> <p>3. Banks and financial institutions shall submit the internal procedures set forth in article 23.2 to the FIU – not later than 60 days after the entry into force of the present article or 30 days after the establishment of the bank or financial institution. If the procedures are in breach of this, the FIU shall notify the bank or financial institution of the breaches. The bank or financial institution shall submit amended procedures within 30 days.</p>	<p>funksiju revizora radi analize sistema izveštavanja i identifikacije</p> <p>3. Banke i finansisjke institucije dostaviće OFJ-u procedure iz člana 23.2, najkasnije 60 dana od dana na stupanja na snagu ovog zakona ili 30 dana nakon osnivanja banke i finansisjke institucije. Ako se procedure krše, OFJ će upoznati banke i finansisjku instituciju o kršenjima. Banke i finansisjke institucije, izmenjene procedure će dostaviti u roku od 30 dana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 24 Detyrimet shtesë të OJQ-ve</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Additional Obligations of NGOs</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Dodatne obaveze NVO</p>
<p>1. Përpos asaj që është paraparë në nenin 24.3, një OJQ nuk pranon kontribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite të vetme.</p> <p>2. Përpos asaj që është paraparë në nenin 24.3, një OJQ nuk do të paguajë para që tejkalojnë 5.000 euro brenda një dite të vetme cilitdo marrësi të vetëm.</p> <p>3. OJQ-të që kërkojnë lirim të njehershëm ose të vazhdueshëm nga detyrimet e nenit 24.1 dhe 24.2, mund të dorëzojnë një kërkesë me shkrim tek NJIF-ja për t'u liruar, duke potencuar llojin e kërkuar të lirimit dhe arsyet për të. NJIF-ja i përgjigjet po me shkrim kërkesës me shkrim brenda 30 ditëve dhe mund të vendosë që ta</p>	<p>1. Except as provided in article 24.3, an NGO shall not accept any contribution in currency in excess of € 1,000 from a single source in a single day.</p> <p>2. Except as provided in article 24.3, an NGO shall not disburse currency in excess of €5,000 in a single day to any single recipient.</p> <p>3. NGOs seeking a one-time or recurring exemption from the obligations under articles 24.1 or 24.2 may file a written request for exemption with the FIU setting forth the nature of the exemption sought and the reasons for it. The FIU shall respond to the request in writing within 30 days, and may decide to grant, conditionally</p>	<p>1. Sem onog predviđenog u članu 24.3, NVO ne sme primiti doprinose u novcu preko 1000 evra od istog izvora u toku jednog dana.</p> <p>2. O sim toga što je predviđeno u člano 24.3, NVO nesme platiti u novcu iznos preko 5000 evro u toku jednog dana jednom primaocu.</p> <p>3. NVO koje zahteva jedno k, ratno izuzeće ili stalno izuzeće iz obaveze člana 24.1 i 24.2, može to tražiti pismeno OFJ-u naglašavajući vrstu, i razlog u tome. Pismenom zahtevu OFJ odgovara u roku od 30 dana, pismeno, i može da odobrava, pod</p>

<p>lejojë, ta lejojë me kusht ose ta refuzojë lirimin. Nëse NJIF-ja vendos ta lejojë ose ta lejojë me kusht një lirim, një kopje të vendimit të vet ia dorëzon organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134).</p>	<p>grant, or deny the exemption. If the FIU decides to grant or conditionally grant an exemption, it shall provide a copy of its decision to the competent body under Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134).</p>	<p>uslovom ili da odbije izuzeće. Ako OFJ odobrava ili uslovno odobrava izuzeće, kopiju svoje odluke dostavlja nadležnom organu na osnovu Zakona o slobodi pridruživanj u NVO (Nr. 03/L-134).</p>
<p>4. OJQ-të do të ruajnë llogaritë të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Llogaritë do të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, me para ose me urdhërpagesë, do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. Dokumentet e llogarive do të ruhen pesë vite dhe do të jenë në dispozicion për inspektim me kërkesë të NJIF-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134).</p>	<p>4. NGOs shall maintain accounts that document all income and disbursements. The accounts shall identify income by source, amount, and manner of payment, such as currency or payment order, and identify disbursements by recipient, intended use of funds, and manner of payment. Account documents shall be maintained for five years and shall be available for inspection upon demand by the FIU and the competent body under Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134).</p>	<p>4. NVO vode i održavaju račune o svim prihodima i rashodima. Računi prikazuju prihode prema izvoru, iznosu, i načinu isplata u novcu ili nalogom za isplatu i identifikuju toškove prema priamaocu, nameni korišćenja fondova i način isplate. Dokumenta će se čuvati 5 godina i biće na raspolaganju za kontrolu prema zahtevu OFJ i nadležnom organo prema Zakonu o slobodi pridruživanja NVO (Nr. 03/L-134).</p>
<p>5. OJQ-të i raportojnë NJIF-së të gjitha aktet apo transaksionet e dyshimta brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.</p>	<p>5. NGOs shall report any suspicious act or transaction to the FIU within three business days and prior to taking further action in connection with any such act or transaction.</p>	<p>5. NVO izveštavaju OFJ sva akta i sumnjive transakcije u roku od 3 ratna dana i pre preduzimanja dalje procedure vezano za takvu transakciju ili akt.</p>
<p>6. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134), një OJQ në raport do të shpalojë:</p> <p>6.1. çdo kontribut në para gjatë vitit nga një burim i caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributeve nga ai burim gjatë vitit</p>	<p>6. When filing an annual report pursuant to article 18 of the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134), an NGO shall disclose in the report:</p> <p>6.1. each contribution in currency during the year from a particular source, if the total value in currency of the contributions from that</p>	<p>6. Prilikom dostavljanja godišnjeg izveštaja, u skladu sa članom 18 zakona o slobodi pridruživanja NVO (Nr. 03/L-134), prikazaće sledeće:</p> <p>6.1. svaki doprinos u novcu u toku godine od određenog izvora ako je iznos u novcu</p>

<p>tejkalon 5.000 euro, duke identifikuar burimin, shumën dhe datën e çdo kontributi; dhe</p> <p>6.2. çdo pagesë në para gjatë vitit që i dedikohet marrësit të caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para e pagesave dedikuar atij marrësi tejkalon 10.000 euro, duke identifikuar marrësin, shumën, datën e çdo pagese dhe destinimin e shfrytëzimit të parave.</p> <p>7. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134), një OJQ do të vërtetojë se i përmbush të gjitha detyrimet e këtij neni.</p> <p>8. Organi kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134) mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të ndonjë dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Nr. 03/L-134). Imponimi i sanksionit të tillë nuk çënon çfarëdo procedure penale.</p> <p>9 Pavarësisht nga cilado dispozitë tjetër ligjore, raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (Nr. 03/L-134), do t'i vihen në dispozicion NJJF-së me rastin e paraqitjes së kërkesës.</p>	<p>source during the year is in excess of €5,000 identifying the source, amount and date of each contribution; and</p> <p>6.2. each disbursement in currency during the year to a particular recipient if the total value in currency of disbursements to that recipient is in excess of €10,000, identifying the recipient, amount and date of each disbursement, and the intended use of the money.</p> <p>7. When filing an annual report pursuant to article 18 of the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134), an NGO shall certify that it has complied with all obligations under the present article.</p> <p>8. The Competent body under the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134) may suspend or revoke the registration of an NGO for violation of any provision of the present article pursuant to article 21 of the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134). The imposition of such sanction shall be without prejudice to any criminal proceedings.</p> <p>9. Notwithstanding any other provision of law, reports filed by NGOs pursuant to the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (No 03/L-134), shall be made available upon request to the FIU.</p>	<p>iz tog izvora u toj godini prelazio 5.000 evra, identifikujući izvor, iznos, datum svakog doprinosa; i</p> <p>6.2. svaku u platu u toku godine namenju određenom primaocu ako je opšte iznos u novcu tom primaocu prelazio 10.000 evra, identifikujući iznos, datum svake u plate i destinaciju novca.</p> <p>7. Prilikom gišnjeg izveštaja iz člana 18 zakona o slobodi pridruživanja NVO (br. 03/L-134), NVO će dokazati da ispunjava obaveze prema ovom članu</p> <p>8. Nadležni organ prema Zakonu o slobodi pridruživanja NVO (br. 03/L-134), može obustaviti ili opozvati upis NVO zbog kršenja odredaba ovog člana u skladu sa članom 21 zakona o slobodi pridruživanja NVO (br. 03/L-134). Ovakva sankcija će biti bez prejudiciranja bilo koje krivične procedure.</p> <p>9. Bez obzira na druge zakonske odredbe, predati izveštaji NVO u skladu sa zakonom o slobodi pridruživanja NVO (br. 03/L-134), biće na raspolaganju OFJ prilikom podnošenja zahteva.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 25 Detyrimet shtesë të partive politike dhe kandidatëve të regjistruar</p>	<p align="center">Article 25 Additional Obligations of Political Parties and Registered Candidates</p>	<p align="center">Član 25 Dodatne obaveze političkih partija i registrovanih kandidata</p>
<p>1. Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk pranojnë kontribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite të vetme.</p> <p>2. Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk i paguajnë një marrësi të vetëm para që tejkalojnë 5.000 euro brenda një dite të vetme.</p> <p>3. Partitë politike do të ruajnë librat e kontabilitetit të cilat identifikojnë të ardhurat sipas burimit, shumës, mënyrës së pagesës, siç është pagesa me para apo me urdhërpagesë dhe pagesat nga palët për çdo person, destinimin e pagesës si dhe mënyrën e kryerjes së pagesës. Librat e kontabilitetit ruhen shtatë vjet dhe do të jenë në dispozicion të NJIF-së dhe Zyrës së Regjistrimit të partive politike për inspektim me rastin e paraqitjes së kërkesës.</p> <p>4. Partitë politike i raportojnë NJIF-së për akte ose veprime bankare të dyshimta brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.</p> <p>5. Raportet financiare gjashtëmujore të dorëzuara në pajtim me nenin 19 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/11, do të përfshijnë:</p>	<p>1. Political parties and registered candidates shall not accept any contribution in currency in excess of € 1,000 from a single source in a single day.</p> <p>2. Political parties and registered candidates shall not disburse currency in excess of €5,000 in a single day to any single recipient.</p> <p>3. Political parties shall maintain accounting books that record all income by source, amount and manner of payment, such as by currency or payment order, and all payments made by the party to any person, the purpose of the payment and the manner in which the payment was made. Accounting books shall be maintained for seven years and shall be available for inspection upon demand to the FIU and the Political Party Registration Office.</p> <p>4. Political Parties shall report any suspicious act or transaction to the FIU within three working days and prior to taking further action in connection with such act or transaction.</p> <p>5. Bi-Annual Financial reports filed pursuant to Section 19 of UNMIK Regulation No.2004/11, shall include:</p>	<p>1. Političke partije i registrovani kandidati ne smeju primiti doprinos u novcu preko 1000 evra iz jednog izvora u toku jednog dana.</p> <p>2. Političke partije i registrovani kandidati ne smeju isplatiti jednom primaocu u novcu iznos preko 5.000 evra u jednom danu</p> <p>3. Političke partije vode knjige koje identifikuju prihode prema izvoru, iznosu, načinu isplate, kao što je isplata u novcu ili uputnicom ili isplata od stranaka o svakom licu, na menu isplate i način isplate. Knjige se čuvaju 5 godine i biće na raspolaganju po zahtevu OFJ-u i kancelariji registrovane političke partija, radi kontrole prilikom podnošenja zahteva.</p> <p>4. Političke partije izveštavaju OFJ-u o sumnjivim bankarskim postupcima u roku od 3 radna dana i pre preduzimanja daljih koraka o takvoj transakciji.</p> <p>5. Šestomesečni finansijskih izveštaji iz člana 19 Uredbe UNMIK-a br. 2004/11 obuhvataju:</p>

<p>5.1. regjistrin e çdo kontributi për partinë politike të regjistruar nga një burim i vetëm, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributeve nga ai burim ka tejkaluar 100 euro gjatë periudhës së raportuar i cili duhet të tregoj:</p> <p>5.1.1. vlerën e çdo kontributi dhënë partisë politike;</p> <p>5.1.2. datën në të cilën është dhënë kontributi;</p> <p>5.1.3. emrin e plotë, adresën dhe regjistrimin civil, numrin e pasaportës apo lejes së vozitjes së kontribuesit; dhe</p> <p>5.2. një deklaratë që identifikon çdo pagesë të bërë ndaj ndonjë personi tjetër gjatë periudhës së raportuar, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave për atë person gjatë asaj periudhe tejkalon shumë prej 5,000 € dhe ndikimin e qëllimit të pagesës.</p> <p>6. Partia politike do të vërtetojë në raportin e saj financiar gjashtëmujorësh se i ka përmbushur të gjitha detyrimet nga ky nen. Kandidati do të vërtetojë se i përmbushin detyrimet nga nenet 25.1. dhe 25.2. në formularin e tij/saj të regjistrimit të kandidatëve dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.</p> <p>7. Zyra për regjistrimin e partive politike mund të hetojë përputhshmërinë e partisë politike me këtë nen dhe mund të pezullojë ose revokojë</p>	<p>5.1. a record of all contributions to the registered political party from a single source if the combined value of contributions from that source has exceeded €100 during the period covered by the report which shall indicate:</p> <p>5.1.1. the value of each contribution made to the political party;</p> <p>5.1.2. the date on which each contribution was made; and</p> <p>5.1.3. the full name, address and civil registration, passport or driver's license number of the contributor; and</p> <p>5.2. a statement identifying each payment made to another person during the period covered by the report, if the total value of all payments to that person during the period exceeds € 5,000 and indicating the purpose of the payment.</p> <p>6. A political party shall certify in its Bi-annual financial report that it has complied with all obligations under the present article. A candidate shall certify in his/her candidate registration form submitted to the Central Election Commission that he/she shall comply with articles 25.1 and 25.2.</p> <p>7. The Political Party Registration Office may investigate a political party's compliance with the present article and may suspend the registration</p>	<p>5.1. registar svakog doprinosa registrovanog od jednog izvora ako je iznos u novcu za doprinos prelazio 100 evra u izvestilačkom periodu koji treba da prikaže:</p> <p>5.1.1. iznos svakog doprinosa datoj političkoj partiji</p> <p>5.1.2. datum plaćanja doprinosa;</p> <p>5.1.3. puno ime i adresu i civilni registar, broj pasoša ili vozačke dozvole davaoca doprinosa, i</p> <p>5.2. jedna izjava koja identifikuje svaku u platu od ređeno lica u izvestilačkom periodu ako je iznos svih uplata u tom periodu prelazio 5.000 evra i uticaj i namena uplate.</p> <p>6. Politička partija u svom 6 mesečnom finansijskom izveštaju dokazati da je ispunila sve obaveze iz ovog člana. Kandidat će potvrditi da je ispunio obaveze iz člana 25.1 i 25.2. u svom obrascu kandidata Centralnoj izbornoj komisiji.</p> <p>7. Kancelarija za upis političkih partija može da istražuje usklađenost političke partije sa</p>
---	---	---

<p>regjistrimin për shkelje të cilësdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/11. Sanksioni nga ky paragraf nuk çfarëdo procedurë penale.</p> <p>8. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, raportet e dorëzuara nga partitë politike në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/11, do të vihen në dispozicion të NJIF-së me rastin e paraqitjes së kërkesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Detyrimet shtesë të avokatëve, noterëve, kontabilistëve të certifikuar, auditorëve të licencuar dhe këshilltarëve tatimor</p> <p><u>Identifikimi i klientëve</u></p> <p>1. Avokatët, noterët, kontabilistët dhe auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor (më tutje “profesionistët në fjalë”) do ta verifikojnë emrin dhe adresën dhe në rastin e personave, datën e lindjes të çdo klienti para kryerjes së shërbimeve profesionale për klientin. Nenet 17 dhe 18.4 deri në nenin 18.6 do të zbatohen për verifikim dhe identifikim. Nëse profesionisti në fjalë nuk mund ta identifikojë klientin ose ta verifikojë identitetin e tij/saj, ai/ajo nuk do të pranojë pasuri nga klienti ose në emër të tij për asnjë qëllim.</p> <p><u>Trajtimi i pasurisë së klientit</u></p>	<p>of a political party for a violation of any provision of the present article in accordance with section 5 of UNMIK Regulation No. 2004/11. A sanction under the present paragraph shall be without prejudice to any criminal proceedings.</p> <p>8. Notwithstanding any other provision of law, reports filed by political parties pursuant to UNMIK Regulation No. 2004/11 shall be made available upon request to the FIU.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Additional Obligations of Lawyers, Notaries, Certified Accountants, Licensed Auditors and Tax Advisors</p> <p><u>Identification of Clients</u></p> <p>1. Lawyers, notaries, certified accountants, licensed auditors and tax advisors (hereafter “covered professionals”) shall verify the name and address, and, in the case of persons, date of birth, of every client before performing professional services for the client. Articles 17 and 18.4 to 18.6 shall apply to verification and identification. If the covered professional is unable to identify a client or verify his or her identity, he or she shall not accept property from or on behalf of the client for any purpose.</p> <p><u>Handling of Clients’ property</u></p>	<p>ovim članom i obustavi ili opoziva upis zbog kršenja odredaba ovog člana u skladu sa članom 5 Uredbe UNMIK-a br. 2004/11. Sankcija is ovog člana nema posledice po krivični postupak.</p> <p>8. Bez obzira na druge zakonske odredbe, podnešeni izveštaj političkih partija u skladu sa Uredbom UNMIK-a 2004/11, ostavlja se na raspolaganje OFJ-u po potrebi.</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Dodatne obaveze advokata, beležnika, licenciranih knjigovođa, revizora i poreskih savetnika</p> <p><u>Identifikacija klijenata</u></p> <p>1. Advokati, beležnici, licencirane knjigovođe, revizori i poreski savetnici (u daljem tekstu “navedeni profesionalci”) proveriće ime i adresu u slučaju osoba, datum rođenja svakog klienta pre obavljanja profesionalne usluge. Članovi 17 i 18.4 do Člana 18.6 identifikovaće klijenta ili proveriće njegov identitet i ne sme primiti klijenta imovinu ili u njegovu ime ni za koji cilj</p>
---	--	---

<p>2. Kur profesionisti në fjalë në cilëndo kohë posedon me pasuri në emër të klientit apo palës së tretë, profesionisti përkatës do të:</p> <p>2.1. mbajë pasurinë në xhirollogarinë, ose në kasafortën, e bankës e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes së BQK-së, përveç nëse klienti në mënyrë qartë pajtohet që pasuria të trajtohet ndryshe, ose kur lloji i pasurisë këtë nuk e lejon;</p> <p>2.2. shënojë në titullin ose destinimin e xhirollogarisë se pasuria mbahet në emër të klientit ose klientëve të profesionistit në fjalë;</p> <p>2.3. në rastin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide, do të ruajë një shumë në xhirollogari e cila në çdo kohë është baras ose tejkalon shumën e pasurisë së klientit që mbahet nga profesionisti në fjalë; dhe</p> <p>2.4. mbajë shënime të plota dhe të sakta, të cilat me rastin e kërkesës janë në dispozicion të klientit, duke treguar të gjitha qëndrimet me pasurinë e klientit dhe duke e veçuar pasurinë e klientit nga pasuritë tjera të cilat mbahen nga profesionisti në fjalë.</p>	<p>2. When a covered professional at any time comes into possession of property on behalf of a client or third party, the covered professional shall:</p> <p>2.1. hold the property in an account of, or in the safekeeping of, a bank subject to the supervision of the CBK, unless the client explicitly agrees that the property should be dealt with otherwise, or the nature of the property does not permit;</p> <p>2.2. indicate in the title or designation of the account that the property is held on behalf of a client or clients of the covered professional;</p> <p>2.3. in the case of cash or liquid securities, maintain a sum in the account that at all times equals or exceeds the sum of the client's property held by the covered professional; and</p> <p>2.4. maintain full and accurate records, available to the client upon request, showing all dealings with the client's property and distinguishing the client's property from other property held by the covered professional.</p>	<p><u>Tretiranjë imovine klientja</u></p> <p>2. Kada dotični profesionalac poseduje u bilo koje vreme imovinu u ime klientja ili treće stranke, dotični profesionalac će:</p> <p>2.1. držati imovinu u bankarsku račun u koja podleže kontroli CKB sem ako se klient izričito slaže da se imovina drugačije tretira, ili kada vrsta imovine to ne do pušta</p> <p>2.2. da navodi u naslovu ili namenu žiro računa da se imovina drži u ime klientja dotičnog profesionalca</p> <p>2.3. u slučaju gotovog novca ili vrednostih likvidnih hartija zadržava jedan iznos u žiro račun u koji je uvek jednak ili prelazi iznos imovine klientja; i</p> <p>2.4. vodi pune i tačne evidencije koje po potrebi budu na raspolaganju klientu o svim pozicijama imovine klientja i odvajajući imovinu klientja od drugih koje drži dotični profesionalac.</p>
<p><u>Raportimi</u></p> <p>3. Çdo profesionist në fjalë i cili, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, pranon para nga klienti në shumë prej 10.000 € apo më shumë, për një transaksion ose transaksione të lidhura</p>	<p><u>Reporting</u></p> <p>3. Any covered professional who, in the course of performing services for a client, receives € 10,000 or more in currency in a transaction or related transactions from a client, shall file a report with</p>	<p><u>Izveštavanje</u></p> <p>3. svaki navedenih profesionalac koji u toku obavljanja usluga klientu prima od 10.000 evro iznos ili veći u novcu od klientja za</p>

<p>me të, do të dorëzojë raport tek NJIF-ja brenda 15 ditëve nga transaksioni i raportueshëm. Transaksioni gjithashtu do të raportohet nëse profesionisti në fjalë i pranon paratë si ndërmjetësues, që do të thotë se ai ose ajo tenton të transferojë paratë tek pala e tretë në emër të klientit. Transaksioni nuk do të ndahet në transaksione të shumta për t'iu shmangur raportimit sipas këtij neni.</p>	<p>the FIU within ten business days of the reportable transaction. A transaction shall also be reported if the covered professional receives the currency as an intermediary, that is, he or she intends to transfer the currency to a third party on behalf of the client. A transaction may not be divided into multiple transactions in order to avoid reporting under this article.</p>	<p>jednu transakciju, podneće izveštaj OFJ-u u roku 15 dana od transakcije. Transakcija će se izvestiti takođe ako navedenih profesionalac prima novac kao posrednik što znači pokušava da prenosi novac kod treće stranke u ime klijenta. Transaksija se neće deliti na više njih da bi se izbegla obaveza iz ovog Člana .</p>
<p>4. Për qëllime të nenit 25.3, “transaksioni” përfshin mes tjerash, por nuk është i kufizuar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. shitjen e mallrave dhe shërbimeve; 4.2. shitjen e pasurisë së patundshme; 4.3. shitjen e pasurisë së paprekshme; 4.4. qiradhënien e pasurisë së patundshme ose personale; 4.5. këmbimin e parave për mjete të tjera monetare, duke përfshirë edhe para të tjera; 4.6. pagesën e një borxhi të mëparshëm; 4.7. pagesën e shpenzimeve të paguara; 4.8. vazhdimin ose ripagesën e huas; apo 4.9. pagesën e taksave në para profesionistit në fjalë për shërbimet e tij ose saj. 	<p>4. For the purposes of article 25.3, a “transaction” includes, but is not limited to:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. a sale of goods or services; 4.2. a sale of real property; 4.3. a sale of intangible property; 4.4. a rental of real or personal property; 4.5. an exchange of currency for other monetary instruments, including other currency; 4.6. the payment of a pre-existing debt; 4.7. a reimbursement of expenses paid; 4.8. the making or repayment of a loan; or 4.9. the payment of fees in currency to the covered professional for his or her services. 	<p>4. u smilsu člana 25.3, “transakcija” između ostalog obuhvata i ne ostaje samo na:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. prodaju roba i usluga; 4.2. prodaju nepokretne imovine; 4.3. prodaju nematerijalne imovine; 4.4. davanje pod zakup nepokretne lične imovine; 4.5. razmenu novca za druga monetarna sredstva uključujući i drugi novac 4.6. otplačivanje ranje obaveze; 4.7. isplatu troškova ; 4.8. nastavak isplate pozajmice; ili 4.9. isplatu taksi u novcu navedenog profesionalva za njegove usluge.
<p>5. Për qëllime të nenit 25.3, shprehja “transaksione të ndërlidhura” do të thotë të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe 24-orëshe ose të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej më shumë se 24-orëve, nëse</p>	<p>5. For the purposes of article 25.3 the term “related transactions” means all transactions conducted between the client and the covered professional in a 24-hour period or all transactions conducted between the client and the covered professional during a period of more than 24 hours if the recipient knows or has reason to</p>	<p>5. S smislu Člana 25.3, pojam “povezane transakcije” znači sve transakcije između klijenta i dotičnog profesionalca u periodu o 24 sata ili sve transakcije između klijenta i dotičnog profesionalca u periodu dužem od 24 sata ako je primaoc u poznat ili ima</p>

<p>marrësi është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni se secili transaksion është njëri prej një sërë transaksionesh të ndërlidhura. Pagesat e shumta që i bëhen avokatit për përfaqësim në një rast të vetëm janë transaksione të ndërlidhura.</p> <p>6. Forma dhe mënyra e raportimit do të rekomandohet nga NJIF-ja dhe përfshin:</p> <p>6.1. emrin, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese të rekomanduara nga NJIF-ja të personit apo subjektit nga i cili janë marrë paratë dhe çdo përfaqësuesi në emër të të cilit vepron personi apo subjekti;</p> <p>6.2. shuma e parave të marra;</p> <p>6.3. data dhe lloji i transaksionit; dhe</p> <p>6.4. informacione të tjera, duke përfshirë edhe identifikimin e personit a të subjektit që e ka dorëzuar raportin e rekomanduar nga NJIF-ja.</p> <p>7. Kontabilistët e certifikuar dhe auditorët e licencuar do t'i raportojnë NJIF-së për çdo lloj akti apo transaksioni të dyshimtë brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë. Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-ja.</p> <p>8. Përveç rasteve të parapara në nenin 25.9, avokatët e angazhuar në aktivitete specifike do t'i raportojnë NJIF-së për akte apo transaksione të dyshimta brenda tri ditëve të punës dhe para</p>	<p>know that each transaction is one of a series of connected transactions. Multiple payments to a lawyer for representation in a single case are connected transactions.</p> <p>6. The form and manner of the report shall be prescribed by the FIU, and shall include:</p> <p>6.1. the name and address, and such other identifying information as the FIU may prescribe, of the person or entity from whom the currency was received and any agent on whose behalf the person or entity is acting;</p> <p>6.2. the amount of currency received;</p> <p>6.3. the date and nature of the transaction; and</p> <p>6.4. such other information, including the identification of the person or entity filing the report, as the FIU may prescribe.</p> <p>7. Certified accountants and licensed auditors shall report any suspicious act or transaction to the FIU within three business days and prior to taking further action in connection with any such act or transaction. Reports shall be made in a form and manner prescribed by the FIU.</p> <p>8. Except as provided in article 25.9, lawyers engaged in specified activities shall report any suspicious act or transaction to the FIU within three business days and prior to taking further</p>	<p>razloga da je upoznat da je svaka transakcija jedna u nizu povezanih transakcija.</p> <p>Isplate koje su brojne, advokat za zastupanje slucajeva je medjusobno povezana transakcija.</p> <p>6. način i oblik izveštavanje preporučuje OFJ-u uključujući:</p> <p>6.1. ime, adresu druge identifikacione podatke preporučene od OFJ za osobu ili subjekta od kojeg je primljen novac i svakog predstavnika u čije ime radi lice ili subjekt</p> <p>6.2. iznos primljenog novca;</p> <p>6.3. datum i vrsta transakcije;</p> <p>6.4. druge informacije uključujući identifikaciju lica ili subjekta koje predaj izveštaj OFJ-u.</p> <p>7. Licencirane knjigovođe, i revizori izveštavaju OFJ o svakoj sumnjivoj transakciji u roku od 3 radna dana i pre preduzimanja daljih postupaka vezano za tu transakciju. Izveštaj se sastavlja u formi koju preporučuje OFJ</p> <p>8. Osim slucajeva iz člana 25.9, angozovani advokati u specifične aktivnosti, izveštavaju OFJ-u o sumnjivim aktima i</p>
---	---	--

<p>ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme lidhur me aktin ose transaksionin e tillë. Në aktivitete specifike përfshihen:</p> <p>8.1. ndihma ose përfaqësimi i klientit apo klientëve në:</p> <p>8.1.1. blerjen apo shitjen e pasurisë së paluajtshme ose të organizatave të biznesit;</p> <p>8.1.2. trajtimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër;</p> <p>8.1.3. hapjen ose menaxhimin e llogarive bankare, librezave të kursimit ose llogarive të letrave me vlerë;</p> <p>8.1.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive;</p> <p>8.1.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive, trusteve ose strukturave të ngjashme; ose</p> <p>8.2. të vepruarit në emër të klientit ose për klientin në çfarëdo transaksioni financiar apo transaksion mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme.</p> <p>Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga NJIF-ja.</p> <p>9. Avokati nuk jep informacione të cilat ai/ajo i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin, për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale a gjyqësore pa autorizim nga klienti ose me</p>	<p>action in connection with any such act or transaction. Specified activities include:</p> <p>8.1. assisting or representing a client or clients in:</p> <p>8.1.1. buying and/or selling of immovable property or business organizations;</p> <p>8.1.2. handling of clients' money, securities, or other assets;</p> <p>8.1.3. opening or managing bank, savings or securities accounts;</p> <p>8.1.4. organization of contributions necessary for the creation, operation or management of companies;</p> <p>8.1.5. creation, operation or management of companies, trusts or similar structures; or</p> <p>8.2. acting on behalf of or for the client in any financial or immovable property rights transaction.</p> <p>Reports shall be made in a form and manner prescribed by the FIU.</p> <p>9. A lawyer shall not, without authorization from the client or by court order, provide information he or she received from a client or obtained on a client in order to represent the client in criminal</p>	<p>transakcijama u roku 3 radna dana i pre preduzimanja daljih postupaka u vezi stim U takve specifične aktivnosti spadaju:</p> <p>8.1. pomoć ili zastupanje klijenta:</p> <p>8.1.1. Kupo-prodaja nepokretne imovine ili poslovnih organizacija;</p> <p>8.1.2. Tretira novca klijenta, vrednosni papira ili druge imovine;</p> <p>8.1.3. Otvaranje ili vođenje bankarskih računa, štednjih knjižica ili računa vrednosnih;</p> <p>8.1.4. Organizovanje potrebni doprinosa za formiranje, rad i upravljanje kompanija;</p> <p>8.1.5. Formiranje rad, i upravljanje kompanija, trusta ili sličnih struktura, i</p> <p>8.2. postupanje u ime klijenta ili za klijenta u bilo kojoj finansijskoj transakciji ili transakciji o pravima na nepokretnu imovinu.</p> <p>Izveštaj se priprema na način i formu koju preporučuje OFJ</p> <p>9. Advokat ne sme dati informacije koje je primijo od klijenta ili je saznao od njega radi njegovog sa stupanja u krivičnom ili</p>
--	---	--

<p>urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillë ose ndihmë nga avokati për të kryer një vepër penale.</p> <p>10. Shënimet e grumbulluara në pajtim me nenin 26 do të ruhen për një periudhë pesëvjeçare nga dita e përfundimit të marrëdhënies afariste apo përfaqësimit. Shënimet relevante për aktin apo transaksionin e dyshimtë do të ruhen për një periudhë pesëvjeçare nga dita kur në NJIF është raportuar akti ose transaksioni i dyshimtë. Sa të jetë e mundur, shënimet e ruajtura në pajtim me këtë nen do të ruhen ndaras nga dosjet që përfshijnë të dhëna që i nënshtrohen të drejtës së posaçme avokat-klient.</p> <p>11. Profesionistët në fjalë do të sigurojnë aftësimin e të gjithë anëtarëve të personelit, të punëtorëve dhe të përfaqësuesve në lidhje me detyrimet që dalin nga ky Ligj.</p> <p>12. NJIF-ja, në konsultim me Shoqatën e Avokatëve të Kosovës dhe Bordin Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar, dhe çdo shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionistëve në fjalë, do të caktojë standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjes së parave nga profesionistët në fjalë dhe do t'i mbikëqyr ata. Këto procedura mes tjerash do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:</p> <p>12.1. procedurën për identifikimin e klientit;</p>	<p>or judicial proceedings, unless the lawyer reasonably believes that the client is seeking the lawyer's advice or assistance to commit a criminal offence.</p> <p>10. Records collected pursuant to article 26 shall be maintained for a period of five years from the date that the business relationship or representation ended. Records relevant to a suspicious act or transaction shall be maintained for a period of five years from the date on which the suspicious act or transaction was reported to the FIU. To the extent possible, records maintained pursuant to the present article shall be maintained separately from files containing information subject to lawyer-client privilege.</p> <p>11. Covered professionals shall ensure the training of all staff members, employees and agents in their obligations under this Law.</p> <p>12. The FIU, in consultation with the Kosovo Bar Association, the Kosovo Board on Standards for Financial Reporting and any other relevant professional association of covered professionals shall establish minimum standards, written procedures and controls for the prevention and detection of money laundering by covered professionals and supervise them. These procedures shall include, but need not be limited to, the following:</p> <p>12.1. a client identification procedure;</p>	<p>sudskom postupku, bez ovlašćenja klijenta ili bez naloga suda, sem ako advokat s razlogom veruje da klijent zahteva njegov savet ili pomoć da bi počinio krivično delo.</p> <p>10. Prikupljeni podaci iz člana 26 čuvaju se 5 godina od dana okončanja poslovnog odnosa ili zastupanja.</p> <p>Relevantni podaci o sumnjivoj transakciji ili aktu čuvaju se 5 godina od dana kada je izeštavano OFJ-u o sumnjivoj transakciji ili aktu. U skladu sa ovim zakonom, takvih podaci se čuvaju, po mogućnosti odvojeno od drugih podataka koji podležu posebnog prava advokat-klijent.</p> <p>11. Navedeni profesionalci obezbeđuju sposobnost svih članova personala i predstavnika vezano za obaveze iz ovog zakona.</p> <p>12. OFJ- u konsultaciji za advokatskom komorom Kosovai Kosovskim odborom sa standarde finansijskog izveštavanja odrediće minimalne standarde, pisane procedure i kontrolu za sprečavanje i otkrivanje pranja novca od navedenih profesionalaca i nadgledaće ih. Ove procedure između ostalog obohvataju ine ostaju samo na tome:</p>
---	---	--

